



AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 190/19), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural publikon e publikon këtë

THIRRJE PUBLIKE nr. 06 / 2021 për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021

I. LËNDË E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e mbështetjes financiare për masat e mëposhtme:

Kodi i masës	Emri i masës
Masa 131	Shoqërimi ekonomik i ekonomive bujqësore për kryerjen e përbashkët të veprimtarisë bujqësore
131.1	Ndihmë për themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore

II. SHFRYTËZUESIT

Të drejtë në shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Kodi i masës
Kooperativat bujqësore të regjistruara në Regjistrin e kooperativave në kuadër të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për kooperativat bujqësore	Masa 131

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mbështetja financiare ka të bëjë për shpenzimet e pranueshme të bëra në periudhën prej 01.01 deri 31.12.2020.

Mbështetja financiare ndahet në shumën prej 100% të shpenzimeve totale të pranueshme.

Mbështetja financiare për pagesë për drejtuesin e kooperativës bujqësore e cila në pajtim me kushtet e përcaktuara mund ta realizon të drejtën e ndihmës nga ky lloj në shumën prej 100% në vitin e parë, nga rroga mesatare e paguar në Republikën e Maqedonisë për vitin e kaluar, me ulje prej 20% për çdo vit të ardhshëm në periudhën jo më të gjatë se pesë vjet.

Mbështetja financiare për angazhimin e një personi nga fusha e shkencave bujqësore dhe veterinarit, në pajtim me llojin e kooperativës bujqësore në shumën jo më shumë se rroga mesatare e paguar në Republikën e Maqedonisë vitin e kaluar (për kooperativave bujqësore nga kapaciteti i madh).

Mbështetja financiare e ndarë është e pakthyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DORËZOHET

Kërkesat për një nënmasë parashtrihen në origjinal.

Një shfrytëzues parashtron kërkesë veç për secilën masë në origjinal. Një shfrytëzues mund të parashtrijë më së shumti 2 kërkesa për këtë masë ose më së shumti 2 kërkesa për masa të ndryshme duke marrë parasysh masat e tjera të Programit të Mbështetjes Financiare të Zhvillimit Rural për vitin 2021.

Kushtet që duhet të plotësojnë kërkuessit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021 ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 21/2021, 31/2021, 53/2021, 79/2021, 92/2021 dhe 121/2021))
- Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014, 25/2015, 73/2015, 83/2015, 154/2015, 11/2016, 53/2016, 120/2016, 163/2016, 74/2017, 83/2018, 27/2019 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.152/2019, 244/2019 dhe 275/2019)
- Ligjin për kooperativat bujqësore ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr.23/13, 51/15, 193/15 dhe 39/16)
- Rregullorja për kriteret më të afërta për përzgjedhjen e shfrytëzuesve sipas masave për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17 dhe 162/18)
- Rregullorja për kushtet më të afërta shtesë për mbështetjen e masave të zhvillimit rural, kostot e pranueshme dhe shumën e mbështetjes për kostot e pranueshme për përdorues për masë individuale ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16, 101/17 dhe 162/18).

Kërkuessit e mbështetjes financiare duhet të parashtrijnë kërkesë të rregullt dhe të plotësuar në tërësi për pagesën e mjeteve për Masën 131 së bashku me dokumentacionin shoqëruar të cekur në kërkesën.

Nëse deri te Agjencia parashtrihen më shumë kërkesa ngaqë ka mjete në disponim për masën 131, në pajtim me Programin për mbështetje financiare në zhvillimin rural për vitin 2021, Agjencia do tu jep përparësi atyre kërkuessve të cilët i kanë parashtruar kërkesat më herët se të tjerët.

V. TËRHEQJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMET

Formularët "Kërkesë për pagesë" me listën e dokumenteve të duhura mund të shkarkohen në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e cekur më lartë mund të merren edhe direkt në Agjencinë çdo ditë pune prej orës 08:30 deri 16:30 në adresën:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

bul. "3 Makedonska brigada" nr.20

(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C) 1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për pagesën e mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021 së bashku me dokumentacionin e duhur parashtrihen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur në të cilin në anën e përparme në këndin e lartë të majtë shënon "MOS E HAP", për Thirrjen publike numër 06/2021 dhe shënim të shifrës së masës për të cilën parashtrihet kërkesa. Kërkesa mund të parashtrihet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritje të vonuar ose të pakompletuar në sportel ose hapje të parakohshme të kërkesës.

Afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave për pagesë për këtë thirrje publike është 31 korrik 2021.

Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen.

Informacione më të hollësishme në tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe

faqen e internetit: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakti:

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural,

Spektori për aprovimin e pagesave

Telefoni: 02 3097-460, çdo ditë pune nga ora **08:30** deri në orën **16:00**

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk